

Fëmijët dhe zhvillimi i tyre



Informacione mbi ekzaminimin për regjistrimin në shkollë (ESU)

Ne jemi këtu për ju



Kinder- & familienfreundlicher
Landkreis Calw

Të nderuar prindër, të nderuar kujdestarë ligjorë,

një ndër qëllimet e rëndësishme të ekzaminimit për regjistrimin në shkollë (ERS) është:

I.) «SHFRYTËZIMI I KOHËS PËR NJË PROMOVIM OPTIMAL»

a) ERS është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët dhe zhvillohet në dy hapa.

- Hapi 1: në vitin e parafundit të kopshtit, përpara datës zyrtare të hyrjes në shkollë, asistentet tona mjekësore ekzaminojnë të gjithë fëmijët në qarkun e bashkisë dhe të Landit (ekzaminimi bazë). Fëmijët, tek të cilët është i nevojshëm kontrolli mjekësor ose diagnostikimi i nivelit gjuhësor, do të thirren të marrin pjesë në një ekzaminim shtesë.
- Hapi 2: në vitin e fundit të kopshtit do të pasojë, në rast se nevojitet, një ekzaminim i mëtejshëm.

b) Të gjitha rezultatet e ekzaminimit i nënshtrohen ruajtjes së fshehtësisë mjekësore.

II.) Çfarë është ekzaminimi bazë?

Në ekzaminimin bazë do të konstatohet gjendja shëndetësore dhe niveli i zhvillimit të fëmijës (Hapi 1). Qëllimi i këtij takimi nuk është vetëm konstatimi i «aftësisë për shkollë».

Në rast se promovimi do të jetë i nevojshëm, mbetet akoma kohë të mjaftueshme për të filluar me të.

III.) Si zhvillohet ekzaminimi?

Ekzaminimi bazë kryhet normalisht në institucionet e kopshteve dhe zgjat rreth 45 minuta. Ju mund ta shoqëroni fëmijën tuaj gjatë ekzaminimit. Edhe nëse ju nuk do të jeni prezent gjatë ekzaminimit, ju do të merrni gjithsesi informacione të detajuara mbi të.

IV.) Çfarë do të ekzaminohet?

Asistentja mjekësore kontrollon fushat e mëposhtme të zhvillimit të fëmijës:

- Aftësitë pamore dhe dëgjimore
- Aftësinë gjuhësore
- Aftësia e mbajtjes mend
- Aftësitë motorike
- Zhvillimi i vizatimit
- Kuptimi i numrave dhe bashkësive
- Gjatësia dhe pesha

V.) Cilat dokumente nevojiten?

Në ditën e ekzaminimit, ju lutemi të sillni me vete dokumentet në vijim:

- **deklaratën e miratimit** të plotësuar dhe të nënshkruar
- **pyetësin për prindërit ose kujdestarin ligjor** të plotësuar
- **Früherkennungsheft** për fëmijë ose **Teilnahmekarte** (paraqitja është e detyrueshme)



Burimi: Gemeinsamer Bundesausschuss



Burimi: bvkj



- **Libri i vaksinave** ose një deklaratë me shkrim, që fëmija juaj nuk është i vaksinuar (paraqitja është e detyrueshme)



- nëse ju ndodhen, **raportet mjekësore** të rëndësishme mbi sëmundjet e fëmijës suaj
- për mbajtësit e syzeve: **Merrni syzat me vete**

Asistentja dokumenton informacionet dhe ju do të këshilloheni mbi vaksinimet.

VI.) Si do të njoftohet rezultati i ekzaminimit?

Ju do të merrni prej nesh një raport me shkrim, të cilin ju lutemi ta përcillni edhe te mjeku juaj pediatër. Në rast se ju jepni miratimin tuaj, institucioni i kopshtit do të vihet në dijeni mbi rezultatet e ekzaminimit dhe sipas rastit, mbi planifikimin e masave pedagogjike promovuese.

Për më tej ju do merrni edhe një këshillues për prindër nga ne, me këshilla mbi promovimin e mëtejshëm të fëmijës suaj.

VII.) Përse na nevojiten deklaratat e miratimit?

Një bashkëpunim ndër-disiplinor është shumë i rëndësishëm për promovimin optimal të fëmijës suaj.

Që ne të kemi mundësinë e bashkëpunimit me ekspertët pedagogjikë, na nevojitet miratimi juaj.

Këtu mund të gjeni një **udhëzues për prindërit** me informacion dhe këshilla aktuale se si mund ta mbështesni me lojëra zhvillimin e fëmijës suaj në shtëpi:



Landratsamt Calw
Gesundheit und Versorgung
Kinder- und Jugendgesundheitsdienst
Vogteistr. 42-46
75365 Calw
Tel. (07051) 160 - 901
Fax: (07051) 160 - 949
esu@kreis-calw.de

Mit freundlicher Unterstützung des Ministeriums für
Soziales, Gesundheit und Integration Baden-Württemberg,
www.sozialministerium.baden-wuerttemberg.de